

Raport i ndermjetem

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

Sipas vendimi 374 date 09.06.2017 kam lidhur kontraten per monitorimin e fushates zgjedhore te subjektit politik Partia per Drejtesi, Integrim e Unitet me date 10.06.2017.

Menjehere me nenshkrimin e kontrates, njoftohem nga perfaqesuesit e KQZ-se per verifikimin e nje problematike ne lidhje me afishimin e materialeve propagandistike ne Bashkine Cerrik, nga subjekti qe une monitoroj.

Ne date 11.06.2017 u nisa menjehere per verifikim ne Bashkine Cerrik dhe konstatova se:

Ne zbatim te nenit 5 te ligjit 90/2017 kam verifikuar zyrat elektorale te PDIU -se ne qytetet Cerrik, Peqin, Rrogozhine. Nga verifikimi ne terren me date 11.06.2017, rezulton se eshte zbatuar me korrektese kjo kerkese e ligjit dhe konkretisht:

Ne qytetin e Cerrikut ishin 3 zyra elektorale ne 3 lagje te qytetit.

E para ne qender te qytetit afer Bashkise Cerrik,

e dyta ne lagjen nr 2 rruga "Rinia" dhe

e treta ne lagjen "Kantieri".

Ne te tre zyrat kishte postera, afishime ne adeziv te logos se PDIU-se dhe flamuj te saj por jo me larg se 5 m nga zyra. Nga komunikimet qe pata me treguan se ka pasur edhe postera ne vende te tjera, por qe i kane hequr sipas kerkesave te ligjit, duke bere sistemimet perkatese per secilen lagje.

Ne Peqin ne qytet ishte vetem nje zyre elektorale ne vendin e quajtur "Kryqezimi" dhe qe kishte te afishuara materiale elektorale te PDIU si dhe flamuj ne shkallet e nderteses. Ne qytet aktualisht nuk kishte postera ne vende te tjera te kesaj partie, (por edhe per partite e tjera nuk kishte postera). Zyra elektorale kishte ne Bishqem (buze rruges nacionale), Perparim, Gjocaj e Karine.

Ne Rrogozhine ne qytet ishin 2 zyra elektorale afer qendres se qytetit, por qe ju perkasin lagjeve te ndryshme. Edhe ketu materialet elektorale ishin vendosur ne zyrat elektorale dhe ne shkallet e godines.

Ky informacion do te jete pjese e raportit te ndermjetem javor.

Bashkelidhur jane fotot e zyrave elektorale.

Date 12.06.2017

Eksperte financiare

Eleda Dhima

